

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU

Nrfaq/Br.str. 112
Datë/Datum. 05.05.2023
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 04.05.2023

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 27.04.2023, pas shqyrtimit të Propozimit për shqyrtimin e dytë të Projekt-Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave për vitet 2023-2027, në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (ç), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 8, nenin 10, të Ligjit për Mbeturina, (Gazeta Zyrtare nr. 23/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M


**Për miratimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave për vitet
2023-2027 në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës**

1. Për miratimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave për vitet 2023-2027, në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, i cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh mënyrën e menaxhimit të mbeturinave për vitet 2023-2027, në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave për vitet 2023-2027, në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike e Mjedisit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,
Drejtorisë së SHPM dhe Arkivës.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Ali Ismaili**





**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



Datë: 04.05.2023

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 27.04.2023, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 374, të datës 14.04.2023, paraqitur nga Drejtoria e Arsimit, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 5, shkronja (d) të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068, (Gazeta Zyrtare Nr.30/2008), nenin 20, të Ligjit për Arsimin Para - universitarë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, (Gazeta Zyrtare Nr. 17/2011), nenin 6 paragrafi 1, 2, 3 dhe nën paragrafët 3.1, 3.2 dhe 3.3, të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit Nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues para - universitarë në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (n), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj) të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 48, paragrafi 8, të Rregullores për Organizimin Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunalet Nr. 125, të datës 25.09.2014 mori:

V E N D I M

**Për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit për rekrutimin e Drejtorit të Institucionit
Parashkollorë në Fushë-Kosovë**

1. Për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit për rekrutimin e Drejtorit të Institucionit Parashkollorë në Fushë-Kosovë.
2. Për konkursin e Drejtorit të Institucionit Parashkollorë në Fushë-Kosovë me Nr. 269, të datës 21.03.2023, përzgjidhet Komisioni në përbërje prej tre anëtarëve si vijon:
 - 2.1 Elmie Grajçevci Zymeri - Kryetare e Komisionit, përfaqësuese e Drejtorisë Komunale të Arsimit;
 - 2.2 Esat Simnica - anëtar i Komisionit, drejtor në Shollën Filllore të Mesme të Ulët 'Selman Riza' në Fushë-Kosovë;
 - 2.3 Përfaqësuesi nga Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, anëtar i Komisionit;
 - 2.4 Një anëtar nga Këshilli i Prindërve në cilësinë e vëzhguesit dhe
 - 2.5 Një anëtar nga Këshilli i Institucionit Parashkollorë në cilësinë e vëzhguesit.
3. Anëtarët nga paragrafi 2, nënparagrafet 2.3, 2.4 dhe 2.5 për komisionin rekrutues, kompletohen me emra përmes komunikimit dhe shkresave zyrtare të Drejtorisë së Arsimit.

4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Arsimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së Arsimit, Anëtarëve të Komisionit dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DIREKTORIA E ADMINISTRIMIT - DIREKTORIJA ZA ADMINISTRACIJU

Nr./No. _____ 115
Datë/Date _____ 05.05.2023
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE

Datë: 04.05.2023

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 27.04.2023, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 139, të datës 29.03.2023, i paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban, të shqyrtuar në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, shkresën me Nr. 40-2/23, të datës 25.01.2023, të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës dhe shkresën Nr. 0-910/6, të datës 25.01.2023, të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shkresës tjetër me Nr. 954/23, të datës 28.03.2023, të dorëzuar tek Drejtoria e Planifikimit Urban nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2 shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 53, të Ligjit për Procedurën Administrative Nr. 05/L-031, (Gazeta Zyrtare Nr. 19/2016), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për shfuqizimin e vendimit Nr. 287 të datës 30.12.2022 dhe rregullores Nr. 289 të datës 30.12.2022 për bonuse të zonimit

1. Për shfuqizimin e vendimit Nr. 287 të datës 30.12.2022 dhe rregullores Nr. 289 të datës 30.12.2022 për bonuse të zonimit, shkresën me Nr. 40-2/23, të datës 25.01.2023, të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës dhe shkresën Nr. 0-910/6, të datës 25.01.2023, të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shkresës tjetër me Nr. 954/23, të datës 28.03.2023, të dorëzuar tek Drejtoria e Planifikimit Urban, nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës.
2. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së GJKP, Drejtorisë së PU dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili

